

Përgatitur nga

Selami Xhepa¹

Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ISB/ACIT)

Hyjre:

Nevoja për thellimin e e mëtejshëm të liberalizimit tregtar në kuadër të zonës së tregtisë së lirë në rajon

Tregtia midis vendeve të rajonit, me përjashtim të tregtisë midis shteteve të ish-Jugosllavisë, siç provohet nga statistikat e tregtisë së jashtme, mbetet shumë e pazhvilluar (shih, Uvalic, 2003). Ky nivel i shkëmbimeve tregtare mund të jetë më shumë rrjedhojë e zhvillimeve historike në rajon se e preferencave konsumatore për mallrat apo arsyeve të tjera me bazë ekonomike.

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) janë konsideruar si një instrument i rëndësishëm në promovimin e paqes dhe stabilitetit rajonal, ashtu si dhe në thellimin e integritimit ekonomik e tregtar, me përfitime ekonomike për vendet e përfshira dhe qytetarët e tyre. MTL syojnë të përmbushin dy qëllime: (i) të testojnë aftësinë e vendeve të rajonit për të vepruar në marrëveshje tregtare kooperuese; dhe (ii) të krijojnë më shumë tregti mes vendeve të rajonit, duke reduktuar varësinë e tyre nga tregjet Europiane.

Preferencat e vendeve të rajonit për t'u angazhuar në negociata bilaterale, në vend të një iniciative multilaterale dhe krijimit të një zonë të vërtetë të tregtisë së lirë, mund të konsiderohet si provë e mungesës së një vullneti politik nga të gjithë vendet e përfshira në iniciativë. Për rrjedhojë, duket se mungon edhe gatishmëria për të thelluar procesin e liberalizimit. Sidoqoftë, në procesin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, nevoja për të bashkëvepruar dhe kooperuar më shumë mes autoriteteve negociuese dhe zbatuese të politikave tregtare, bëhet më e evidente dhe më kërkuese.

Vendet e rajonit kanë arritur një shkallë të lartë të liberalizimit tregtar si pjesë e reformave të tranzicionit. Nivelet e tarifave doganore janë reduktuar ndjeshëm dhe në pjesën më të madhe të mallrave dhe vendeve, nuk përbëjnë ndonjë kufizim serioz në qarkullimin tregtar. Për rrjedhojë, edhe reduktimet dhe/ose eliminimet e tarifave, nuk pritet të japin ndonjë efekt të ndjeshëm në tregtinë e mallrave. Reduktimet e barrierave jo-tarifore, lehtësimi i tregtisë nëpërmjet një harmonizimi të procedurave dhe rregullave të tregtisë dhe zhvillimi i projekteve të përmirësimit të transportit dhe infrastrukturës së transportit, ndoshta janë me efekte shumë më të rëndësishme në stimulimin e tregtisë. Kostot e këtyre barrierave mund t'i tejkalojnë ndjeshëm kostot e tarifave doganore. Në këtë këndvështrim, thellimi i liberalizimit tregtar duke u zgjeruar dhe në produkte apo sektorë të tjerë, nuk pritet të sjellë efekte të rëndësishme në sektorin prodhues të ekonomisë së vendit; dhe për shkak të volumeve të ulëta të shkëmbimeve, as në nivelin e të ardhurave të buxhetit nga doganat.

Me qëllim që efektet e MTL-ve të jenë pozitive dhe të mos shkaktojnë deformime në kuadrin e sistemit multilateral të tregtisë, liberalizimi duhet të jetë sa më i plotë, siç përcaktohet në nenin XXIV të GATT. Në respektim të kësaj kërkese të legjisacionit të OBT-së, MTL me vendet e rajonit, sipas MoU (artikulli 1.2.2) duhet të përfshijnë jo më pak se 90 për qind të linjave tarifore

¹ Autori i këtij materiali është Menaxheri i Kërkimeve pranë ACIT, një projekt i Institutit të Studimeve Bashkëkohore (ISB) financuar nga USAID. Mendimet e shprehura janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht të institucionit ku ai është i punësuar.

dhe të volumeve të importeve. Në fakt, jo të gjitha 21 marrëveshjet bilaterale tashmë të nënshkruara (dhe shumica janë efektive që nga fillimi i vitit 2004) e kanë plotësuar këtë kriter. Sipas Vijkman (2003), Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë të nënshkruara nga Shqipëria² nuk respektojnë këtë kriter, respektivisht:

- Me Kroacinë dhe Rumaninë: kriterin e mbulimit 90 për qind të linjave tarifore;
- Me Maqedoninë dhe Serbinë dhe Malin e Zi, kriterin e mbulimit të 90 për qind të vëllimit të importeve; dhe
- Me Bullgarinë nuk i plotëson asnjërin nga të dy kriteret.

Praktikisht, nëse Shqipëria dëshiron të përmbushë detyrimet e saj në kuadër të MoU, **së paku** duhet të rishikojë këto marrëveshje me të gjitha vendet e rajonit me qëllim zgjerimin e listave të mallrave të përfshira në këtë iniciativë.

Tabela 1: Shkalla e liberalizimit të tregtisë së Shqipërisë në rrjetin e MTL me vendet e rajonit

Marrëveshjet	Totali tregtisë, %		Bujqësia		Industria	
Shqip-Maqedoni	92 (80)	93 (90)	42 (19)	52 (65)	100 (100)	100 (100)
Shqip-BiH	91 (92)	93 (88)	39 (60)	51 (0)	100 (100)	100 (100)
Shqip-SM	90 (38)	89 (89)	29 (15)	27 (0)	99 (100)	99 (100)
Shqip-Bullgari	86 (70)	87 (84)	5 (0)	11 (0)	99 (100)	99 (100)
Shqip- Rumani	86 (100)	87 (88)	5 (80)	10 (0)	99 (100)	99 (100)
Shqip- Kroaci	86 (96)	87 (53)	5 (0)	14 (0)	99 (100)	99 (100)

Burimi: Vijkman (2003) (Note: kolona e parë shënon shifrat për Shqipërinë ndërsa e dyta i referohet vendit partner; në kllapa shënohet shifra sipas vëllimit të importeve, ndërsa jashtë kllapave sipas linjave tarifore).

Duke analizuar sektorët e liberalizuar sipas vendeve me qëllim identifikimin e atyre që potencialisht mund të shtohen, rezulton se praktikisht përpjekjet e mëtejshme për liberalizim duhet të shihen vetëm brenda sektorit të bujqësisë, pasi praktikisht sektori industrial është liberalizuar thuajse tërësisht (me përjashtim të disa sektorëve të cilët janë konsideruar si sensitiv dhe që do të liberalizohen gradualisht deri në vitin 2008).

Kuota apo liberalizim tarifor? – mund të ishte një pyetje që ka nevojë të argumentohet dhe të mbahet qëndrim. Disavantazhet e kuotave tashmë janë të mirënjohura dhe të evidentuara si në teorinë ekonomike, ashtu dhe në praktikën e tregtisë ndërkombëtare. Ndarja e përfitimeve në rastin e kuotave shkon kryesisht në favor të një grupi firmash eksportuese dhe jo në përfitim të shoqërisë (në formën e çmimeve më të ulëta). Nga ana tjetër, monitorimi dhe alokimi i kuotave bëhet një tjetër burim korrupsioni për doganat, aq më tepër kur ato janë tashmë dhe institucioni më i kritikuar për nivelin më të lartë të korrupsionit.

² Edhe vendet e tjera nuk realizojnë plotësisht përmbushjen e të dy kriterëve: Kështu: MTL e Bullgarisë me Maqedoninë dhe Serbi e Mali i Zi nuk plotësojnë kriterin e linjave tarifore; MTL e Bosnje-Herzegovinës me Rumaninë dhe Bullgarinë nuk plotësojnë kriterin e vëllimit të importeve; ndërsa MTL e Rumanisë me Maqedoninë dhe Kroacinë nuk plotësojnë asnjërin nga kriteret.

Qëllimi i këtij material është të shikojë se cilët do të ishin produktet që mund t'i shtohen listave që mund të liberalizohen dhe ato produkte për të cilat mund të kërkohet hapja e tregjeve nga negociatorët. Për këtë qëllim, kemi analizuar avantazhet e shfaqura të krahasuara me secilin nga vendet e rajonit. Avantazhet e shfaqura krahasuese llogariten me formulën:

$$RCA_i^j = \frac{(X_i^j - M_i^j)}{(X_i^j + M_i^j)}$$

RCA_i^j - janë avantazhet e shfaqura krahasuese për produktin i ndaj vendit j

X_i^j - vlera e eksportit të mallit i drejt vendit j


M_i^j - Vlera e importit të mallit i nga vendi j

Ky tregues merr vlerën nga -1 në +1 dhe monitoron zhvillimet e marrdhënieve import-eksport për produkte të caktuara dhe në raport me një vend apo grupe vendesh përgjatë kohës. Vlera pozitive shpreh avantazhe krahasuese për një produkt të dhënë ndaj vendit të dhënë; ndërsa vlera negative shpreh mungesë të avantazheve në atë produkt. I analizuar në dinamikë, ky koeficient tregon nëse vendi po fiton apo po humbet avantazhet krahasuese ndaj një vendi apo një grupi vendesh. Kjo analizë është bërë në dinamikë tre vjeçare, duke mbuluar periudhën 2000-2002 dhe për produktet sipas sistemit të harmonizuar deri në nivel 4 shifror. (Aneksat bashkëlidhur)

Përmbledhja e rezultateve të këtij ushtrimi sipas vendeve të veçanta jepet në vazhdim të këtij materiali (në mënyrë analitike rezultatet jepen në anekset bashkëlidhur).

1. Tregtia me Maqedoninë

Marrëveshja e parë e tregtisë së lirë me vendet e rajonit që ishte negociuar dhe që ka filluar të veprojë në Shqipëri ishte ajo me Maqedoninë. MTL ka filluar të jetë në fuqi që nga 15 Korrik 2002.



Duke përjashtuar vitin 2000, eksportet shqiptare drejt Maqedonisë kanë arritur me një rritje modeste, por të qëndrueshme, ndërsa importet kanë qenë më të luhatshme. Megjithatë, volumi i importeve e tejkalon me rreth pesë herë vlerën e eksporteve duke bërë që bilanci tregtar edhe me Maqedoninë të jetë negativ me rreth 15 milionë dollarë.

Një ndër tiparet më të dallueshme në tregtinë midis dy vendeve që vërehet është se ajo bazohet kryesisht në shkëmbime rastësore të produkteve, pa mundur të shfaq një vijimësi në produkte.

Kështu, në listën prej 62 produktesh që vendi ynë ka eksportuar drejt Maqedonisë përgjatë tre viteve, vetëm gjysma e tyre (30 produkte) janë përsëritur në të paktën dy vite. Nëse përjashtohet lista me 4-5 mallra që janë në volume të mëdha (si bimët medicinale, produkte të naftës dhe disa makineri e pajisje (që në fakt janë riekspor), me një vlerë eksporti që luhetet midis 250-460 mijë dollarëve, volumi mesatar i eksportit vjetor të një produkti 10 mijë dollarë.

Duke analizuar listën e mallrave të shkëmbyera për periudhën 1999-2002, në mesatarisht 450 produkte të shkëmbyera (sipas regjistrimit katërshifror), në vetëm 30 produkte janë identifikuar koeficientë pozitive të RCA brenda një viti në raport me Maqedoninë.


Vlera pozitive të koeficientit hasen në 62 raste përgjatë gjithë periudhës tre vjeçare; në vetëm 2 raste ndeshen vlera pozitive të koeficientit në të tre vitet (produktet e kreut 1211: bimë medicinale dhe 2501: kripë); ndërsa në vetëm 11 raste ndeshen vlera pozitive në dy vite.

Tregtia në mallrat bujqësore dhe efektet e MTL-së.

Tregtia në mallrat e bujqësisë dhe agropërpunimit ka qenë në nivele modeste dhe, megjithë hyrjen në fuqi të MTL-së, volumi i shkëmbimeve vazhdon të mbetet në nivele mjaft të ulëta. Nga rreth 7 milionë dollarë importe të mallrave bujqësore në vitin 1999, volumi tyre ka rënë në 4.7 milionë në vitin 2002. Ndërsa eksportet kanë përjetuar rënien më të ndjeshme: nga mbi 1.5 milionë dollarë në vitin 1999, në vetëm 460 mijë në vitin 2002.

Efekti i MTL-së në tregtinë e mallrave në tërësi, dhe atyre bujqësore, në veçanti, duket i papërfillshëm. Importet nga Maqedonia vazhdojnë të dominohen nga produktet që nuk janë në listat e mallrave të liberalizuara. Importet e frutave si mollë dhe rrush, patate, domate, qepë, etj. dhe disa produkteve të tjera ushqimore si maja, ushqime të përgatitura, produkte të qumështit, etj. janë kategoria kryesore e mallrave të importuara. Këto mallra gjenden në mënyrë të qëndrueshme në statistikën e tregtisë së jashtme me këtë vend, që do të thotë se ato kanë krijuar tashmë një treg shitje të qëndrueshëm. Ndërsa eksportet shqiptare vazhdojnë të jenë shumë rastësore, me produkte të ndryshme dhe në volume mjaft modeste, siç dhe u theksua më lart.

Graf 1: Volumi shkëmbimeve të mallrave bujqësore me Maqedoninë, në mijë usd.



2. Tregtia me Bosnje-Herzegovinën.

Tregtia me B&H nuk është thujse aspak e zhvilluar, megjithëse gjatë vitit të fundit ka shenja të fillimit të shkëmbimeve në nivele mjaft modeste. Nga një volum importesh prej rreth 100 mijë dollarë në vitin 2000, pritet që në fund të vitit 2003 importet nga B&H të kapërcejnë vlerën e 1 milionë dollarëve, ndërsa eksportet vazhdojnë të jenë inekzistente.

Një analizë e MTL me B&H


Ndërsa sektori industrisë pritet të liberalizohet tërësisht sipas një skeduli simetrik reduktimesh të tarifave brenda vitit 2007 (pa parashikuar lista produktesh), sektori bujqësisë paraqitet shumë i mbyllur në raport me MTL-në me Maqedoninë. MTL parashikon një listë të përbashkët por të kufizuar mallrash që do të bëhen zero menjëherë dhe një listë tjetër mallrash që do të liberalizohen gradualisht deri në 1 janar 2008.

Nga studimi i listave të mallrave të përfshira në protokollet e MTL-së, rezultojnë se në raport me Maqedoninë shkalla e liberalizimit të sektorit të bujqësisë (klasat 1-24 të HS) është shumë më e ulët.

3. Tregtia me Serbi-Mali i Zi³

Nga nivele mjaft modeste të shkëmbimeve tregtare të regjistruara para vitit 1999 (nën 2 milionë dollarë), që nga viti 2000 kemi një rritje të ndjeshme të qarkullimit të mallrave mes dy vendeve.

Graf: Volumi tregtar me Serbinë dhe Malin e Zi, në mijë USD



Nga rreth 300 mallra të shkëmbyera mes dy vendeve, në mbi 180 prej tyre ndeshen vlera pozitive të RCA. Nga viti 2002 numri i tyre reduktohet me rreth 30, duke nënkuptuar një humbje të avantazheve krahasuese në këto mallra. Në 40 produkte, vlerat pozitive të koeficientëve ndeshen në tre vite rrjesht dhe në 113 produkte ndeshen vlera pozitive në të paktën dy vite.


Tregtia më këtë vend duket se ka një stabilitet më të madh në strukturën e mallrave që shkëmbehen (në raport me gjithë ekonominë e tjera të rajonit), si nga ana e importeve ashtu dhe e eksporteve, duke nënkuptuar një lidhje tregtare të konsoliduar. Nga rreth 340 mallra të shkëmbyera, rreth 150 prej tyre (ose 44 për qind) gjenden në tre vite rrjesht, dhe në 325 raste (ose 93 për qind) janë përsëritur në dy vite; ose e shprehur ndryshe, vetëm 8 për qind e produkteve janë tregtuar vetëm një herë në tre vite të analizuara.

Tregtia në mallrat bujqësore.

³ Në statistikat që i referohen tregtisë me këtë vend, janë të përfshira dhe volume shkëmbimeve me Kosovën, për arsye se Kosova nuk ka një kod të vetin doganor. Për këtë arsye, analiza e të dhënave paraqitet e deformuar. Në të vërtetë, volume shkëmbimeve që i referohet kjo pjesë e analizës i përket kryesisht shkëmbimeve me Kosovën dhe më pak me Malin e Zi dhe Serbinë.

Tregtia në mallrat bujqësore është rritur ndjeshëm, nga rreth 4 milionë dollarë në vitin 2000 në rreth 8 milionë në vitin 2002.

Graf: Tregtia në mallrat bujqësore, në mijë USD



Artikujt kryesor të eksporteve tona janë vezët, lëngjet e frutave dhe uji, produkte ushqimore të përgatitura dhe duhanet dhe cigaret. Ndërsa produktet e importit dominohen nga gruri dhe misri, mielli, vaji vegjetal, birra dhe zarzavatet.

MTL me Serbinë dhe Malin e Zi


Ndërsa tregtia në mallrat industriale është liberalizuar thuajse tërësisht (me një listë produktesh që liberalizohen gradualisht nga të dy vendet), tregtia në mallrat bujqësore mbetet e mbrojtur nga tarifat ekzistuese. Me përjashtim të një liste mallrash për të cilat janë shkëmbyer koncensione për disa sasi modeste të tregtueshme pa tarifa doganore, praktikisht gjithë shkëmbimet e mallrave të klasave 1-24 janë të paliberalizuara. Në këtë kuptim, MTL me këtë vend paraqitet më pak e hapur se me gjithë vendet e tjera të rajonit.

Në 21 produkte/grup produktesh për të cilat ne kemi përfituar koncensione në vetëm 5 produkte vendi ynë ka eksporte të regjistruara me këtë vend, ndërsa po nga 21 produkte/grupe produktesh koncensione të dhëna, më shumë se 10 prej tyre gjenden në listat e mallrave që ne importojmë nga ky vend. Listat e negociuara janë thuajse simetrike, në kuptimin që koncensionet janë bërë në mënyrë reciproke për pothuajse të njëjtat produkte, duke përfshirë dhe ato që janë të rëndësishëm për të dy vendet (të tilla si uji mineral lëngje frutash, birra, verë dhe pije alkoolike, etj.).

4. Tregtia me Bullgarinë


Bullgaria përfaqëson furnizuesin kryesor të importeve nga vendet e rajonit, me rreth 30 milionë dollarë në vit, siç duket dhe në grafikun dhe tabelën më poshtë, ndërkohë që eksportet drejt këtij vendi janë inekzistente, me shifrat ndër më të ulëtat, të krahasueshme me ato të B&H. Me këto shifra, Bullgaria përfshihet në listën e dhjetë partnerëve më të rëndësishëm tregtar të vendit. Në vitin 2002, ai zinte 2.05 për qind të importeve.

Graf: Tregtia me Bullgarinë



Importet e produkteve industriale përbëjnë mbi 70 për qind të totalit, duke u dominuar nga produkte të tilla si letër e karton, produkte të qelqit, materiale ndërtimi (si shufra çeliku, pajisje hidrosanitare, etj), materiale elektrike (përfshirë tela dhe llampa, pajisje elektrike si gjenerator, etj). Ndërsa produktet e agroindustrialisë (kapitullit 1-24) dominohen kryesisht nga drithërat dhe mielli dhe produkte të tyre (si niseshte dhe ushqime të tjera të përgatitura prej miellit, etj) dhe importet e vajit të lulediellit të papërpunuar.

Graf: Tregtia e produkteve bujqësore



Nga analiza e RCA me Bullgarinë rezulton se nga rreth 420 mallra të shkëmbyera, në vetëm 8 raste ndeshen vlera pozitive të koeficientit dhe në mbi 410 mallra të tjera janë vlera negative. Në vetëm 3 raste (produktet me numër HS 0708; 7222 dhe 8417) vlera pozitive përsëritet në dy vite rrjesht dhe në një rast në tre vite rrjesht (produkti me numër HS 0901).

MTL me Bullgarinë

MTL-ja me Bullgarinë ka hyrë në fuqi që nga data 1 Shtator 2003.


Tregtia e mallrave industriale është liberalizuar nga të dy palët, me përjashtim të listave specifike të disa sektorëve me liberalizim gradual, tarifat doganore të të cilëve do të reduktohen gradualisht deri në fund të vitit 2007. Ndërsa tregtia në fushën e bujqësisë dhe agroindustrialisë, vazhdon të mbetet e paliberalizuar. Të dyja palët i kanë akorduar koncensione njëra-tjetrës, në një numër të kufizuar mallrash dhe në sasira të kufizuara. Për këtë arsye, kjo marrëveshje nuk plotëson asnjërin nga kriteret e vendosura në MoU të përfshirjes së 90 për qind të volumit të tregtisë dhe të linjave

tarifore. Për rrjedhojë, vendet duhet të rishikojnë zgjerimin e sektorëve që duhen hapur, kryesisht në fushën e bujqësisë, pasi sektori industrial është tashmë i hapur.

Tregtia me Rumaninë

Nga shifra të papërfillshme, tregtia me Rumaminë ka ardhur në rritje, sidomos që pas vitit 2000 dhe në kahjen e importeve. Pas një rritje të ndjeshme të importeve nga Rumania në vitin 2001 (me mbi 100 për qind ndaj vitit 2000), rritja në vitet pasardhëse ka vijuar normale. Importet e dominohen nga këto mallra: grurë (1001 dhe 1008), vaji ushqimor (1512), produkte energjitike (2704 dhe 2710); materiale hidrosanitare (6910); transformatorë elektrik dhe elektroda (8504 dhe 8545), etj. Numri i mallrave që tregtohen është rritur gjithashtu ndjeshëm: nga vetëm 45 produkte të shkëmbyera në vitin 2000, në vitin 2002 numërohen 85 produkte.

Graf: Tregtia me Rumaninë, në mijë dollarë



Tregtia me Rumaninë dominohet nga mallra industriale, ndërkohë që tregtia në produktet bujqësore dhe ushqimore është tërësisht e papërfillshme. Po kështu, eksportet drejt këtij vendi, siç dhe duken nga grafiku janë inekzistente, për rrjedhojë nuk mund të konsiderohen edhe RCA me këtë vend.

MTL me Rumaninë

MTL me Rumaninë ka hyrë në fuqi nga data 1 janar 2004.


Tregtia në mallrat industriale midis Shqipërisë dhe Rumanisë që nga kjo datë është gati tërësisht e liberalizuar, me përjashtim të një liste produktesh tregtia e të cilave liberalizohet në mënyrë graduale, brenda datës 1 janar 2007.

Ndërsa tregtia e mallrave bujqësore nuk ka ndryshuar, me përjashtim të një liste mallrash që janë shkëmbyer me koncension, për sasi modeste mallrash, dhe për një numër shumë të kufizuar produkesh.

Tregtia me Kroacinë

Kroacia përfaqëson partnerin tregtar më të rëndësishëm të vendit në termat e volumeve të shkëmbimeve me vendet e rajonit. Në vitin 2002, shkëmbimet me Kroacinë arritën në rreth 34.3 milionë dollarë, duke qenë kështu në vendin e parë në rajon dhe duke u renditur në dhjetë partnerët tregtar më të rëndësishëm të vendit (me 2.3 për qind të totalit të importeve).

Tregtia me Kroacinë është rritur ndjeshëm që prej vitit 2000; ajo është rritur me mbi 270 për qind, kryesisht në kahjen e importeve. Po kështu tregtia është diversifikuar: nga vetëm 60 produkte të shkëmbyera në vitin 2000, numri arrin në 93 në vitin 2002.



Prezencë të qëndrueshme në tregun shqiptar kanë krijuar produkte të tilla kroate si: çimento (2523) (mesatarisht 5 milionë dollarë importe në vit), produktet e naftës (2710-2716); drithërat (1001, 1005, 1006); vegla pune (8204) dhe pajisje elektrike (8503; 8535).

Në anën e eksporteve paraqitet e njëjta pamje si dhe në rastin e vendeve të tjera. Nëse nga shifra e vitit 2000 hiqet efekti i eksportit të ferrokromit (rreth 1.1 milionë dollarë) dhe ferrolidhjeve (240 mijë dollarë), volumi i eksporteve do të normalizohej në vlerat që paraqiten dhe në vitet e tjera.

Në këto kushte, është përsëri e tepërt të kërkohen gjetja e avantazheve të shfaqura krahasuese me këtë vend.

MTL me Kroacinë

MTL me Kroacinë ka hyrë në fuqi që prej datës 1 qershor 2003.

Tregtia e produkteve industriale, me përjashtim të një liste të sektorëve që liberalizohen gradualisht deri në 1 janar 2008, liberalizohet menjëherë me hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Sektorët që janë të mbrojtura nga pala kroate përfshijnë: mermerin, naftën, produktet e industrisë së drurit, tekstile e veshje, materialet e ndërtimit, telat e kabllot elektrik, mobiljet e drurit. Sektorët e mbrojtur nga pala shqiptare janë të njëjta si dhe ato që përfshihen në listat me vendet e tjera.

Ndërsa tregtia në mallrat bujqësore bazohet në regjimet tregtare ekzistuese, me përjashtim të koncensioneve të shkëmbyera midis dy vendeve, që përsëri janë në sasi modeste dhe për një numër produktesh mjaft të kufizuara.

Një analizë e koncensioneve sipas produkteve

Shkëmbimi i produkteve bujqësore, siç u evidentua në analizën e mësipërme, do të vazhdojë të mbetet subjekt i masave mbrojtëse tregtare. Tarifat doganore do të vazhdojnë të aplikohen në thuajse gjithë nomenklaturën e tyre, me përjashtim të koncensioneve modeste të shkëmbyera mes palëve. Tabela e mëposhtme paraqet kuotat e eksporteve të vendit tonë drejt vendeve të rajonit pa tarifa doganore, ndërsa tabela tjetër shpreh raportin e kuotave totale të përfituara me vendet e rajonit ndaj eksporteve totale të vitit 2002 (në gjithë vendet dhe jo eksportet totale ndaj vendeve të analizuara) të këtyre produkteve.

Ajo çfarë evidentohet nga një vështrim i këtyre dy tabelave, është se për një numër produktesh, kuotat e përfituara janë shumë më të mëdha se eksportet totale të tyre. Në këtë kategori bëjnë pjesë produkte të tilla si: domatet, shalqi dhe pjepër. Një kategori e dytë mallrash janë ato që kanë një nivel koncensionesh pothuajse të përafërt me totalin e eksporteve të vendit: si molusqet, karrotat dhe kastravecët. Kategoria e tretë, që përfshin një numër më të madh mallrash, janë koncensione të fituara që janë në nivele shumë modeste në raport me totalin e eksporteve. Këtu përfshihen mallra të tilla si: lakra, lulëlakra, fasule, presh e zarzavate të tjera dhe produkte të përpunuara si reçelra, birrë, ujra minerale, etj.

Edhe në studimin e listave të koncensioneve të dhëna vendeve të rajonit (tabela 2), rezultojnë një panoramë: për një grup produktesh, si djath, disa fruta dhe zarzavate të ndryshme, pije, etj, koncensionet e dhëna e tejkalojnë me disa herë volumin e përgjithshëm të importeve të vendit; ndërsa për produkte të tjera, koncensionet përbëjnë vetëm një fraksion modest të volumeve të importeve totale të vendit. Këtu hyjnë produkte të tilla si bulmetrat, perimet e freskëta (kastravec, domate, etj), birra, ujrata minerale, etj.

Tabela 1 : KONCENSIONET PËR MALLRAT BUJQËSORE TE EKSPORTUARA NGA SHQIPERIA DREJT VENDEVE TË RAJONIT (TARIFË 0% BRENDA KUOTES SE SPECIFIKUAR)

NR	Kodi tarifor	Përshkrimi	tonë						Totali
			MQ	KR	RM	Kosova	JG	BG	
			sasia	sasia	sasia				
1	0204	Mishi i deleve apo i dhive, i freskët, i ftohtë, apo i ngrirë		150			100		250
2	0307	Molusqet	Free					100	100
3	04 06 10 80	Djathë	50	100			200	200	550
4	0406902900	Kashkavall	50	150	50	Free	200		450
5	04 07 00 30	Vezët e zogjve në guackë, të freskëta, të ruajtura apo të gatuar		70		Free			70
6	0409 00 00	Mjaltë natyral		50		Free		50	100
7	0701 90 50 20	Patate të freskëta ose të ngrira, nga 1 shkurti deri në 24 maj	300	200		Free			500
8	0702	Domate të freskëta ose të ngrira	150			Free	750		900
9		nga 26 shtatori deri në 31 dhjetor		300					300
10	0703 90 00	Presh dhe zarzavate të tjera të djegëshme		150		Free	200		350
11	0704	Laker, lulelaker,...				Free	100		100
12	0706 10 00	Karrota dhe rrepa të kuqe	200	100			200		500
13	0707 00 05	Kastravecat e zakonshëm e të vegjël, të freskëta apo të ngrira	100	150		Free	500		650
14	0708 20 00 20	Fasule, të freskëta apo të ftohta, nga 1 tetori deri në 31 dhjetor	Free	100	100			400	600
15	0713 31 00	Fasule të llojit Vigna mungo Hepper apo Vigna radiata		100	50	Free			150
16	0802 40	Gështenja (Castanea spp)		100		Free		100	200
17	0804 10 00	Hurma	Free	200				100	300
18	0804 20 90	Fiq, te thara	Free		100			100	200
19	0807	Shalqijte (perjashto periudhen 1 Mars-15 korrik)	2500		500	Free	2000	300	5,300
20	ex 08071100	Produkte të tjera të familjes së bostanit (01.11-30.06) (pjepri)			100	Free	300	200	600
21	081210 00 10	Qershi				Free	50		50
22	1211	Bimë e pjesë të bimëve(përfshirë farat e frutat, të përdorur në parfumeri, farmaceutike...)	Free part.	50		Free		200	250
23	1509 10 11	Vaj ulliri e fraksionet e tij, të rafinuara ose jo, por jo të modifikuara kimikisht	Free	150	100			300	550
24	1601	Sallame dhe produkte te ngjashme mishi	150		50	Free			200
25	1602	Te tjera pergatitje prej mishi	100		50				150
26	2001 90 65	Ullinj, të përgatitura apo të ruajtura në uthull apo acid acetik	Free	100	100	Free	100	500	800
27	2007	Recelet, peltet e frutave, marmalata..	Free					100	100
28	2009(200911,	Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) e lëngje zarzavatësh të pafermentuara e pa		200	100	Free	200	200	700

29	2102	Maja (aktive apo joaktive), mikroorganizmat e tjera një qelizore të vetme, të ngordhura ,	Free	50		Free		50
30	2201	Ujërat, përfshi minerale apo artificiale, ujërat e gazuar që nuk përmbajnë sheqer	Free	150		Free	200	3350
31	2202	Ujra, përfshirë ujrë minerale apo artificiale e ujërat e gazuar, që përmbajnë sheqer	Free	100	1000	Free		1100
32	2203	Birrë bërë nga malti				500	200	700
33	2204	Verë prej rrushit të freskët,përfshirë verat e pasuruara me alkool, musht rrushi përvec atij të kreut 2009				Free	200	200
34	2208 20 12	Konjak	200	75		Free	500	925
35	22082029	Pije të tjera, raki				Free	200	400
36	220870	Likere dhe kordialet				Free	500	500
37	2309 90 97	Përgatitjet e një lloji të përdorur në ushqimin e kafshëve	Free	100			400	500
38	2401 20 60	Duhan i tipit oriental					500	500

Burimi: Raporti Vjetor i Tregtisë së Jashtme, ACIT 2003; Sekretariati i OBT-së

kodi	Pershkrimi	Sasite e eksportit, tone, viti 2002	Kuotat, % te eksporteve totale
307	Molusqet, nese jane apo jo ne guacke, te gjalla, te fresketa, te flohta, te ngrira, te thara, te kripura apo ne uje me kripe; kafshet jovertebrore ujore te tjera vec kafsheve guackore te nenujshme dhe molusqeve, te gjalla, te fresketa, te flohta, te thara	120	83
702	Domate	237	380
704	Laker, lule-laker, rrepa te bardha dhe produkte te ngjashme te ngrreneshme te llojit brassicas, te fresketa apo te flohta :	548	18
807	Pjeptrat (perfshire shalqinjte), dhe papaja (papays), te fresketa :	948	559
1211	Bimet dhe pjese te bimeve (perfshire farat dhe frutat), te nje lloji te perdorur kryesisht ne parfumeri, ne farmaceutike apo per qellime insekticidale, fungicidale apo qellime te ngjashme, te fresketa apo te thara, nese jane apo jo te prera, te shtypura a	10,037	2.5
2007	Recelet, peltet e frutave, marmalatat, pure frutash apo arrash dhe brum frutash apo arrash, qe jane pergatitje te gatuar, nese permbajne apo jo sheqer apo lende te tjera embelsuese shtese :	10,053	1.0
2009	Lengje frutash (perfshire mushtin e rrushit) dhe lengje zarzavatesh, te pafermentuara dhe qe nuk permbajne lende alkoolike shtese, nese permbajne sheqer apo lende te tjera embelsuese shtese :	10,941	6
2201	Ujra, perfshire ujrat minerale natyrale apo artificiale dhe ujrat e gazuar, qe nuk permbajne sheqer apo lende te tjera embelsuese apo aromatizuese shtese; akulli dhe bora :	11,376	29
2202	Ujrata, perfshire ujrata minerale dhe ujrata e gazuar, qe permbajne sheqer apo lende te tjera embelsuese apo aromatizuese shtese, dhe piqe te tjera jo-alkoolike, pa perfshire lengun e frutave apo te zarzavateve te kreut Nr. 2009 :	12,535	9
2203	Birre bere nga malti :	12,567	6
2204	Vere prej rrushit te fresket, perfshire vererat e pasuruara me alkool; musht rrushi pervec atij te kreut Nr. 2009 :	12,570	2
4090000	Mjalte natyral.	742	13
7039000	Preshet dhe zarzavate te tjera te djegeshme	745	47
7061000	Karrota dhe rrepa te kuqe	745	67
7070005	Kastravecet e zakonshem	746	87
7133100	Fasule te llojit Vigna mungo Hepper apo Vigna radiata Wilczek	1,339	11
8071100	Shalqinjte	1,631	325
22082012	Konjak	1,635	57
22082029	Te tjera piqe te fituara nga distilimi i veres se rrushit apo te bersive te rrushit	1,635	31
24012060	Duhan i tipit Oriental sun-cured	2,896	17

Tabela 2. KONCENSIONET PËR MALLRAT BUJQËSORE TË IMPORTUARA NË SHQIPËRI NGA VENDET E RAJONIT (TARIFË 0% BRENDA KUOTËS SË SPECIFIKUAR)			në tonë					
			MQ	KR	RM	JG	BL	Totali
NR	Kodi	Përshkrimi						
1	0403	Dhallë, qumësht e krem i prerë...		50				50
2	0405	Gjalp dhe undyrna dhe vajra ...				200	50	250
3	040610	Djathë i freskët (i papjekur apo i pastazhonuar)+C38	50					50
4	0406 30	Djath I procesuar, jo i ngrirë apo i pudëruar		100		200	200	500
5	0406 90	djathra të tjera		100				100
6	040690 29	Kashkaval	50		50			100
7	0409	Mjaltë			50			50
8	0702	Domate , të freskëta apo të ftohta	150					150
9	0703 20 00	Hudhra					50	50
10	0704 90	Te tjera (lakra te fresketa...)					100	100
11	0707	Kastraveca	100				50	150
12	0709 51 00	Kepurdha					50	50
13	0709 90 70	Kunguj te vegjel					100	100
14	0710 10	Patate (te ngrira), specat (te ngrira), domate (te ngrira), te tjera perime					200	200
15	0712 90	Zaravate te thara,					100	100
16	0713 10	Bizele, mashurka, thjerza ...					100	100
17	080231,32	Lajthi, Arra me dhe pa lëvozhgë			130		200	330
18	0808 10	Mollë (përveç atyre të periudhës 01 Tetor-30 Nëntor)	3000					3000
19	0809 20	Qershi, pjeshke, kumbulla					50	50
20	0811 20	Rrush frengu i zi dhe mana					200	200
21	1001.00	Grurë dhe mislin		5000		2500		7500
22	1101	Miell gruri e meslini				2500		2500
23	1103 13	Bollgur prej misri (si drith)				5000	400	5400
24	11052000.00	Fetëza, granule dhe sfera prej patates			30			30
25	1107.00	Malt, në se është apo jo i pjekur		200				200
26	1501 00 19	Te tjera dhjam derri					100	100
27	1512 19 91	Vaji luledielli				500	300	800
28	1517.00	Margarinë			pa kufi	1500	150	1650
31	1704 90	Ëmbëlsirat prej sheqeri , që nuk përmbajnë kakao	200	100			100	400

32	1806.00	Çokollatat dhe përbërje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao		100	50		100	250
33	1901.00	Ekstrakt malti, përbërjet ushqimore prej miellit, niseshtesë që nuk përmbajnë kakao...		250				0 250
34	1902.00	Brumrat, të mbushura apo jo, të tilla si spageti, makarona, petë..		150		250		400
35	1904	Ushqimet e përgatitura prej bymimit dhe pjekjes ...					100	100
36	1905.00	Bukë, torta, kek, biskota e produkte të tjera të furrëtarit...		200				200
37	1905 30	Biskota te embla, kausha akulloresh ...				100		100
38	2001.00	Zarzatatet, frutat, arrat e pjesë të tjera të ngrënshme të bimeve,		100			100	200
39	2002	Domate te përgatitura ...					100	100
40	2003 10	Kepurdha ...					30	30
41	2005 10	Zarzavate te homogjenizuara ...					150	150
42	2007.00	Reçelet, peltet e frutave, marmalatat, pure frutash apo arrash...		50	50	250		350
43	2008 11	Kikirike ...					150	150
44	2009.00	Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) e lëngje zarzavatesh..		200		200		400
45	200970.00	Lëng molle			100			100
46	2102.00	Maja (aktive apo jo aktive),		50				50
47	2103.00	Salcat e përgatitjet prej tyre, erëza të përziera e aromatizues..		50			60	110
48	2104.00	Supat e lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre....		20	50	100		170
49	2105.00	Akulloret , nëse përmbajnë apo jo kakao		50		100	50	200
50	2106.00	Përgatitje ushqimore të papërfshira dhe të paspecifikuara diku..		150			50	200
51	2201+2202	Ujëra minerale me dhe pa sheqer			1000	200	1500	2700
52	2203.00	Birrë bërë nga malti				200		200
53	2204.00	Verë prej rrushit të freskët...				200		200
54	22082012.00	Konjak				500		500
55	22082026.00	Grapa				200		200
56	220870.00	Likere dhe kordialet				500		500
57	230990.00	Ushqime të qenit apo të maces...				400		400

kodi	Pershkrimi	Importet ne tone	Kuotat, % totalit
40310	- Kos :	515	10
40510	- Gjalpe :	989	25
40610	- Djathe i fresket (i papjekur apo i pastazhionuar) perfshire	71	142
40630	- Djath i procesuar, jo i grire apo i puderzuar :	374	134
40690	- Djathra te tjera :	901	22
40900	Mjalte natyral.	21	238
70200	Domate, te fresketa apo te ftohta.	9876	2
70320	- Hudhra	153	33
70490	- Te tjera :	13	769
70700	Kastravecat e zakonshem dhe kastravecat e vegjel , te fresket apo te ftohte :	1181	13
70951	-- Kerpudha :	21	238
70990	- Te tjera :	403	25
71010	- Patate	445	45
71290	- Zarzavate te tjera; perzierjet e zarzavateve :	28	357
80231	-- Ne guacke	760	43
80810	- Molle :	25466	12
80920	- Qershite :	821	6
81120	- Manaferra te buta, manaferra te egra, mana, rrush logan,	64	313
110100	Miell gruri dhe miell meslini :	97506	3
110313	-- Prej misri (si drith) :	182	2967
150100	Dhjam derri (perfshire sallon) dhe dhjami i shpendeve, ndryshe nga ai i kreut Nr. 0209 apo 1503 :	396	25
151219	-- Te tjera :	12072	7
160100	Sallam dhe produkte te ngjashme, prej mishi , prej te brendshmeve te mishit apo prej gjakut; pergatitjet ushqimore me baze te ketyre produkteve :	628	91
170490	- Te tjera :	1094	37
190410	- Ushqimet e pergatitura fituar nga bymimi apo pjekja e	411	24
190530	- Biskota te embela; kaush akullore dhe vaferet :	5931	3
200210	- Domate, te tera apo ne copa :	276	36
200310	- Kerpudha :	132	23
200510	- Zarzavate te homogjenizuara	12	1250
200811	-- Kikirike	757	20
200970	- Leng molle :	124	81
210500	Akulloret dhe akuj te tjera te ngrenshem, nese permbajne apo jo kakao :	462	43
220110	- Ujrat minerale dhe ujrat e gazuar :	7477	17
220210	- Ujrat, perfshire ujrat minerale dhe ujrat e gazuar, qe	8758	
220300	Birre bere nga malti :	27857	7
220820	- Pije te fituara nga distilimi i veres se rrushit apo te bersive te	34	2059
220870	- Likere dhe kordialet :	139	360
230990	- Te tjera :	602	66

Liberalizimi mëtejshëm tregtar në vendet e rajonit - Konkluzione

Me rrjetin bilateral të MTL-ve dhe diferencat e shfaqura mes tyre, gjenerimi i përfitimeve të supozuara nga liberalizimi tregtar bëhet problematik. Diferencat në listat e produkteve të liberalizuara dhe atyre të mbrojtura në raporte me vende të veçanta, e ndërlikojnë mjaft “leximin” e politikave tregtare të sektorëve dhe reduktojnë kështu ndjeshëm transparencën e regjimit tregtar në rajon.

Plotësimi nga MTL-të i kushtit të përfshirjes së “*substantial trade*”, kusht që përcaktohet në nenin XXIV të OBT-së dhe që është përcaktuar në MoU në shifrën e 90 për qind si të linjave tarifore ashtu dhe të volumit të tregtisë, kërkon që MTL-të që vendi ynë ka nënshkruar me vendet e rajonit të rishikohen drejt zgjerimit. Ndërsa listat e produkteve industriale janë tashmë thuajse tërësisht të liberalizuara, e vetmja fushë ku pritet të zgjerohet liberalizimi mbeten listat e produkteve bujqësore.

Duke qenë se ky proces duhet të vazhdojë gjatë periudhës në vazhdim, një ndër objektivat e procesit duhet të jetë dhe harmonizimi i regjimit tregtar me të gjitha vendet. Nga pikëpamja e mbrojtjes së sektorëve bujqësor, duhet të ndiqet eksperiencia me sektorin industrial, ku kemi një listë simetrike mbrojtje me të gjitha vendet. Po kështu, dhe në sektorin bujqësor duhet të konsiderohet mundësia që të hamonizohen listat me të gjitha vendet. Varianti minimal duket se mund të shërbejë regjimi tregtar me Maqedoninë dhe Kosovën, që kanë dhe shkallën më të lartë të hapjes.

Nga ana tjetër, liberalizimi duhet të thellohet më tej, pasi dhe në rastin e Maqedonisë, nuk plotësohet kushti i vënë. Nga analiza e të dhënave tregtare të importeve me këtë vend rezulton se mallrat e liberalizuara reciprokisht (sipas listës Protokoll A, Aneks 1), zinin 0.5 për qind të totalit të importeve të mallrave bujqësore të viti 2002 (duke u rritur në 0.6 për qind në vitin 2003) dhe 4.9 për ind të importeve totale (nga të gjithë vendet) të mallrave të listës së liberalizuar (5 për qind në vitin 2003).

Analiza e avantazheve të shfaqura krahasuese mes vendeve duket se hedh shumë pak dritë në identifikimin e produkteve ku vendi ynë zotëron avantazhe dhe si të tilla të vazhdojnë të konsiderohen si prioritare për t’u mbrojtur nga rritja e presionit konkurrues nga liberalizimi i regjimit tregtar. Siç demonstron nga vlerat e koeficientëve të RCA të llogaritur për secilin nga vendet e përfshira në analizë, listat e produkteve janë shumë të kufizuara, dhe për më tepër, nuk shfaqin vijimësi ndër vite. Sidoqoftë, ato vazhdojnë të mbeten si një bazë e rëndësishme e gjykimit mbi rekomandimet e dhëna në këtë material. Nga ana tjetër, rekomandimet marrin në konsideratë edhe skedulën e angazhimeve në kuadër të OBT-së.

Nga analiza e listave të mallrave, mendojmë se mund të hapen reciprokisht⁴ këto sektorë dhe të hamonizohen listat me të gjithë vendet e përfshira në rrjetin e MTL-ve:

Klasën: **03 (peshqit)**. Kjo kategori produktesh do të bëhen zero në kuadër të angazhimeve ndaj OBT-së. Ky sektor mund të kërkohet të hapet tërësisht dhe nga palët e tjera, pasi nuk paraqet ndonjë industri të specializuar të rajonit tonë. Vendi ynë gjithashtu nuk ka eksportuar sasi të produkteve të këtij kapitulli në rajon, pasi eksportet e janë realizuar tërësisht në vendet e Bashkimit Evropian.

⁴ Duhet mbajtur në konsideratë fakti se vendi ynë është importues i rëndësishëm për këtë vende. Për rrjedhojë dhe fuqia negociuese është e rëndësishme. Në rast të përgatitjes për negociata, është e nevojshme që të mbahen në konsideratë informacioni i këtij materiali mbi vëllimet e importeve nga këto vende dhe të ushtrohet presion pikërisht në ato produkte ku dhe efektet mund të jenë më të ndjeshme.

Klasën **04** (qumësht dhe produkte të tij): mund të studjohet me industrinë dhe të liberalizohen për shembull qumësht pluhur, i koncentruar, etj; kategori që nuk prodhohen në vend dhe ndoshta industria nuk ka projekte për të ardhmen në këtë drejtim. Nga ana tjetër, nëse prodhuesit e vezëve kërkojnë hapjen e tregjeve të këtij produkti dhe mendojnë se janë në gjendje të shesin dhe në Maqedoni, mund të negociohet që të përfshihet në listën e produkteve të liberalizuara, në mënyrë reciproke nga të gjitha palët, edhe kreu **0407 00** (vezët). Vetëm gjatë vitit 2000 dhe 2001 janë regjistruar importe në sasira të vogla, ndërsa në vitin 2002 nuk janë regjistruar sasi importi ose eksporti.

Klasën **0603 dhe 0604** (lule). Kjo kategori produktesh nuk është importuar asnjëherë dhe ka pak gjasa që të importohen lule nga vendet e rajonit, duke patur parasysh edhe kushtet klimatike të rajonit, mungesën e ndonjë tradite të posaçme dhe të dallueshme, etj. Po kështu mund të kërkohet nga partnerët që dhe ata të hapin tregun e tyre për këto produkte. Duke patur parasysh që volumet e shkëmbimeve janë inekzistente në këto produkte, nuk mendohet të ketë impakte nga kjo masë.

Klasën: **08 03 00** (banane), **0804** (hurma arabie, ananas, avokado, etj - përjashto: *080420* fiq); këto produkte nuk janë karakteristikë e rajonit tonë dhe importet janë kryesisht nga rajonet me klimë tropikale.

Klasën **0901** (kafe), **0902** (caji). Volumet e importeve në këtë kategori produktesh janë minimale dhe furnizuesit kryesor janë nga vende jashtë rajonit tonë. Për rrjedhojë, edhe ato që mund të jenë regjistruar si importe nga këto vende, nuk duhet të jenë produkte me origjinë prej tyre por më tepër janë rieksperte.

Klasën **1006** (oriz). Vendi ynë nuk është prodhues dhe nga ana tjetër, nuk ka importe të këtij produkti nga ky rajoni pasi ai nuk është prodhues i këtij produkti.

Në klasën 14 është përjashtuar vetëm kodi **14 04 20 00** (push pambuku). Ndoshta nuk ka ndonjë arsye që ky artikull të përjashtohet pasi as Maqedonia dhe as vendi ynë nuk njihen si një prodhues dhe eksportues të këtij produkti.

Në klasën **1512** (vaji luledielli). Të gjitha produktet e kreut 15 janë parashikuar zero sipas angazhimeve të OBT-së.

Në klasën **1701**: produktet e sheqerit gjithashtu mund të përfshihen në listat e produkteve të liberalizuara. (Humbjet në buxhet vetëm nga liberalizimi plotësisht i importit të sheqerit do të ishin rreth 750 mijë USD – llogaritur me importet e zhdoganuara gjatë vitit 2002). Sidoqoftë, rekomandimi do të ishte për liberalizim të plotë dhe jo vetëm me vendet e rajonit, pasi do të krijoheshin probleme të kontrollit doganore dhe tregtisë së paligjshme, gjë që e shtyu dhe Komisionin Evropian të rishikonte regjimin e tregtisë së këtij produkti me vendet e rajonit tonë.

Në kapitullin 21 nuk janë përfshirë vetëm produktet e kreut **2101** (ekstrakte, esenca, etj). Të dhënat e importeve për këtë kategori produktesh nuk dëshmojnë ndonjë rëndësi të veçantë të këtyre produkteve, prandaj mund t'i shtohen listës së produkteve të liberalizuara.

Në kapitullin **22** janë mbrojtur birra, vera dhe produkte të tjera të alkoolit, ndërsa janë liberalizuar ujrat minerale, me dhe pa sheqer. Nëse do t'i përmbahemi angazhimeve në kuadër të OBT-së, edhe produktet e berrës dhe verës duhet të liberalizohen duke përfshirë kështu gjithë produktet e këtij kapitulli.

Kapitulli 24 (duhanet) nuk janë liberalizuar. Edhe në këtë kategori mund të shtohen produktet e kreut **2401** (që janë duhane të papërpunuar që mund të shërbejnë si lëndë e parë për industrinë e përpunimit të duhaneve. (Praktikisht nuk kemi importe të këtij zëri). Madje, industria e përpunimit të duhanit thuajse është rrënuar dhe nëse nuk ka ndonjë projekt të rëndësishëm investimi, ndoshta i gjithë kapitulli 24 mund të liberalizohet.

Lista e mësipërme e mallrave që propozohet të shtohet në sektorët e liberalizuar në kuadrin e MTL-ve me vendet e rajonit përshfijnë një volum total të importeve prej 198 milionë USD (shifrat e vitit 2003). Ato përbëjnë rreth 54 për qind të importeve totale të produkteve bujqësore (kapitujt 1-24). Importet nga vendet e rajonit të këtyre mallrave janë rreth 10 milionë dollarë, duke zënë kështu rreth 5 për qind të importeve totale të këtyre produkteve, ose 2.7 për qind të importeve totale të produkteve bujqësore nga të gjitha vendet. Në këto kushte, ndikimet e liberalizimit, qoftë për industrinë e vendit, qoftë për buxhetin e shtetit, do të ishin të parëndësishme.

Mars 2004